

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “BRANKO/ELMAZI LAW FIRM” SH.P.K.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
NENI 1

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, sot me dt. 07.01.2022, me vullnet të lirë Ortakët themelues:

1. **Klodian Branko** mbajtës i mbajtës i kartës së identitetit 032671295, me nr. Personal I01114103J.
2. **Rezart Elmazi** mbajtës i pasaportës nr. BJ2395850, me nr. Personal I10305176I.

si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosën të hartojnë këtë akt themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II
EMRI, FORMA, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 2
EMRI

Emri i shoqërisë është **“BRANKO/ELMAZI LAW FIRM” SH.P.K.** Shkurtimi i emrit do të jetë **“B/E LAW FIRM”**.

NENI 3
FORMA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

NENI 4
SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla nr. 5, ap. nr. 4, Tiranë, 1001, Shqipëri.



Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5

AFATI

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

KREU III

NENI 6

OBJEKTI


Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Zyrë avokatie që ofron shërbime ligjore, ndërmjetësim dhe konsulenca të ndryshme.
- Ofrim i shërbimeve ligjore për individët, personat fizik dhe juridikë shqiptarë e të huaj, përfaqësim i këtyre personave në institucione publike e private si dhe përfaqësim në të gjitha shkallët e gjyqësorit kombëtar e ndërkombëtar, institucione ndërmjetësimi ose arbitrazhi.
- Aktivitet ndërmjetësimi.
- Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji për profesionin e avokatit dhe legjislacioni tjetër në fuqi.
- Kryerja e investimeve fusha të ndryshme të ekonomisë, shit blerje pasuri të paluajtshme.
- Ndjekje të procedurave për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme si dhe përmirësimin dhe përditësimin e tyre.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në vlerën 1000000 ALL (një milion lekë), ndarë në 2 (dy) kuota.



Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1. **Z. Klodian Branko** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit të Shoqërisë i barabartë me 1 kuotë me vlerë 500000 (pesëqind mijë) lekë.
2. **Z. Rezart Elmazi** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit të Shoqërisë i barabartë me 1 kuotë me vlerë 500000 (pesëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar do të derdhet nga ortakët themelues në llogarinë bankare të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

KREU IV ORGANET E SHOQËRISË

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 9 ORGANI ADMINISTRATIV

Administrator i shoqërisë është :

Z. Rezart Elmazi, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. BJ2395850, me nr. Personal I10305176I.

KREU V PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për të marrë pjesë në shoqëri të tjera, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.



NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

LEGJISLACIONI I APLIKUAR

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni tregtar në fuqi.


NENI 13

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Akti i themelimit përpilohet në dy kopje origjinale me te njëjtën fuqi ligjore.

THEMELUES

Klodian Branko

Klodian Branko


Rezart Elmazi

Rezart Elmazi
